



# Metodologjia Montesori për edukimin në fëmijërinë e hershme (mosha 0-6 vjeç)

## *Qëllimi i programit:*

Trajnimi për zbatimin e metodologjisë Montesori nga Shoqata Montesori në Wisbaden të Gjermanisë ka filluar të mbahet për herë të parë në Kosovë në vitin 2019 me një grup të edukatorëve të kopshteve me bazë në komunitet ndërsa është mbajtur në të njëjtën kohë edhe trajnimi për trajnerë i cili ka përfshirë mësimdhënësit e Fakultetit të Edukimit në Universitetin e Prishtinës bazuar në marrëveshjen e mirëkuptimit të nënshruar nga Shoqata Montesori në Gjermani dhe Universiteti i Prishtinës dhe Fakulteti i Edukimit. Trajnimi ka për qëllim përgatitjen e edukatorëve për zbatimin e metodologjisë Montesori bazuar në parimet e kësaj filozofie. Ky trajnim konsiderohet të ketë një vlerë të jashtëzakonshme për ngritjen e cilësisë në sistemin e edukimit parashkollor në Kosovë duke ditur se të drejtën për shpërndarjen e kësaj metodologjie nuk e ka poseduar asnjë organizatë, deri më tani. Trajnimet e para do të mbahen në bashkëpunim me pedagogët nga Gjermania ndërsa më pas Fakulteti i Edukimit në UP do të ketë ekskluzivitetin për mbajtjen e këtyre trajnimeve/ moduleve me të gjithë të interesuarit e kësaj fushe, përfshirë, edukatorët, drejtorët, pedagogët, psikologët etj

## *Grupi i synuar i mësimdhënësve /vijuesve:*

Edukatorët të cilët punojnë me fëmijët e moshave 0-3 vjeç dhe 3-6 vjeç në kopsht ose shkollat fillore me klasat parafillore.

Pjesëmarrësit në këtë trajnim duhet të kenë përvojë pune në profeson, së paku 3 vite për arsye se nevojitet një bazë e kompetencave për punë me fëmijët e moshave përkatëse.

## *Rezultatet e programit:*

Pas përfundimit të trajnimit, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të:

- Stimulojnë fëmijët për zhvillim të shkathtësive për jetë (kujdesin ndaj vetes, ndaj ambientit, mirësjelljen, vetëkontrollit, etj;
- Përkrahin fëmijët për të nxënë duke përdorur të gjitha shqisat;
- Zhvillojnë aktivitete të cilat nxisin të menduarit matematikor përmes punës me materiale specifike montesori;
- Stimulojnë zhvillimin e gjuhës dhe komunikimit tek fëmijët duke përdorur strategji dhe materiale specifike montesori;
- Zhvillojnë aktivitete që nxisin njohjen e vetës, njohjen e të tjerëve dhe njohjen e Botës që na rrethon duke hulumtuar dhe eksperimentuar me materiale specifike;
- Krijojnë materiale didaktike të cilat nxisin zhvillimin dhe të nxënësve të fëmijës.
- Vëzhgojnë dhe dokumentojnë zhvillimin dhe përparimin e fëmijëve si dhe janë në gjendje të planifikojnë dhe nxisin fëmijët në drejtimin që kanë nevojë, interesim dhe dëshirë.